

AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MedRise” shpk

KREU I

**Dispozita të Përgjithshme**

Sot me datën 02 Tetor 2024 të nënshkruarit:

Fabjola Belegu, e bija e Shkëlqim Belegu-t, e datëlindjes 03 Korrik 1993 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal J35703109V dhe

Orges Poda i biri i Sulejman Podo-s, i datëlindjes 27 Nëntor 1979 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H91127094I

Te dy së bashku me vullnet të plotë e të lirë dhe iniciativë të lirë në cilësinë e “Ortakëve të Shoqërisë” mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodi Civil, Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare” dhe ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Biznesit” vendosëm të themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “MedRise” shpk.

KREU II

**EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, ORTAKËRIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË,  
KOHËZGJATJA DHE SELIA**

**Neni 1**

**Emërtimi**

1.1 Emërtimi i shoqërisë është: “MedRise” Shpk.

**Neni 2**



## **Forma Ligjore**

2.1 Shoqëria tregtare “MedRise” Shpk është e organizuar si Shoqëri tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar , shkurtimisht Shpk.

## **Neni 3**

### **Ortakët e shoqërisë**

Ortakët e shoqërisë tregtare “MedRise” Shpk janë Fabjola Belegu dhe Orges Poda. Ortakët gjëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër të gjitha detyrimet që pasqyrohen ne legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në statutin e Shoqërisë deri në vlerën e kapitalit themeltar.

## **Neni 4**

### **Objekti i Veprimitarise**

4.1 Shoqëria “MedRise” do të ketë si objekt veprimitarie:

Tregëtimin dhe distribucion të produkteve OTC me pakicë dhe shumicë.

## **Neni 5**

### **Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë sipas vendimit të Asamblesë së Ortakeve të përcaktuar në këtë statut.

## **Neni 6**

### **Selia e shoqërisë**

6.1 Selia e shoqërisë “MedRise” do të jetë në Tiranë në adresën : Rruga Kongresi i Manastirit, Kompleksi Zirkon, Hyrja D, Nr. 1/1, Njësia Bashkiake Nr.3, Tiranë

6.2 Gjatë veprimitarise së saj shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

  
2

## KREU III

### KAPITALI dhe KUOTAT

#### Neni 7

##### Kapitali i shoqërisë

7.1 Kapitali i rregjistruar i shoqërisë "MedRise" shpk është 2,000,000 (dymilion) Lekë i barabartë me 2(dy) kuota.

7.2 Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e rregjistruar.

7.3 Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tyre dhe vlera nominale e kuotës të secilit ortak llogaritet në raport me secilin kontribut e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas tableës më poshtë:

Nr	Emri I Ortakëve	Kuota	Kontributi i Ortakëve në kapital (Lekë)	Përqindja në kapital
1	Znj.Fabjola Belegu	1	1,000,000	50%
2	Z. Orges Poda	1	1,000,000	50%
	<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>2,000,000</b>	<b>100%</b>

7.4 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe depozitohen për llogari të shoqërisë në të gjitha bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

#### Neni 8

##### Rregjistrimi i kuotave të kapitalit themeltar

8.1 Kuotat dhe zotërueshet e tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, rregistrohen në një rregjistër të posaçëm

8.2 Format dhe modalitetet e tjera të rregjistrat miratohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.3 Forma dhe modalitetet e tjera të këtij rregjistri miratohen me vendim të ortakëve që zoterojnë më shumë se  $\frac{3}{4}$  e kuotave.

### Neni 9

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnet të ortakut**

9.1 Ortakët mund të transferojnë pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet:

- a. kontributit ne kapitalin e shoqërise;
- b. shitblerjes;
- c. trashëgimisë;
- d. dhurimit;
- e. çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Transferimi i këtyre pjesëve brenda shoqërisë mund të bëhet lirisht, ndërsa transferimi tek personat e tretë mund të bëhet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.

### Neni 10

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi**

10.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, nëpërmjet trashëgimisë, si dhe midis bashkëshortëve në rast ndarje pasurore.

10.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, midis bashkëshortëve si dhe midis prindit dhe fëmijës ose anasjelltas.

### Neni 11

#### **Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar**

4

11.1 Në çdo rast transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet të vërtetohet nëpërmjet një akti notarial.

11.2 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar pasqyrohen në rregjistrin e posaçëm të miratuar sipas nenit 9 të këtij Statuti. Mospagimi i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në këtë rregjistër, nuk e bën të pavlefshëm aktin e transferimit.

11.3 Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit jo më vonë se një muaj nga data e rregjistrimit të këtij akti në zyrën notieriale.

11.4 Kërkesa për depozitim e aktit të shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar mund të bëhet nga shitësi ose nga blerësi, ose prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

### Neni 12

#### **Zmadhimi i kapitalit me kontribute në para**

12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para me vendim të asamblesë së ortakëve.

12.2 Zmadhimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet me shlyerjen tërësisht të vlerës së shtuar prej ortakëve.

12.3 Shlyerja e fondeve mund të vërtetohet nga një zyrë notierale ose nëpërmjet një konfermë bankare.

12.4 Në rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit të fondeve, ortakeve u lind e drejta të térheqë fondet e depozituara.

### Neni 13

#### **Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributeve në natyrë**

13.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në natyrë bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.

13.2 Vlera e kontributit në natyrë si shtesë e kapitalit themeltar përcaktohet nga një ekspert, i cili emërohet nga asambleja e ortakëve.

## Neni 14

### Zvogëlimi i kapitalit

14.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të asamblese së ortakëve duke respektuar në çdo rast minimumin ligjor të kapitalit themeltar.

14.2 Vendimi përkatës pasqyrohet në Statut si dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përndryshe është i pavlefshëm

14.3 Nëse e çmon asambleja e ortakëve mund të caktojë një ekspert kontabël për të verifikuar procedurat dhe aktin e vlerësimit.

## KREU IV

### ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

## Neni 15

### Organet drejtuese

15.1 Organet drejuese të shoqërisë “MedRise” shpk janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

## Neni 16

### Asambleja e ortakëve, kopetencat

16.1 Asambleja e ortakëve

- Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
- Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë;
- Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
- Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;

- f. Të miratojë marrveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
- g. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj;
- h. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutin e tij;

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në seline e shoqërisë.

### **Neni 18**

#### **Administratori**

18.1 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve

18.2 Në aktin e emërimit përcaktohet dhe periudha e qëndrimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është përcaktuar në aktin e emërimit atëhere ajo në çdo rast nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet nga dita e emërimit në detyrë.

18.3 Administratori i parë i shoqërisë MedRise shpk është znj. Fabjola Belegu, e bija e Shkëlqim Belegu-t, e datëlindjes 03 Korrik 1993 lindur dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të poltë për të vepruar mbajtës i kartës së identitetit me numër personal J35703109V, e cili emërohet për një periudhë prej 5 vitesh nga momenti i rregjistrimit të këtij fakti në Qendrën Kombëtare të Biznesit

### **Neni 19**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e administratorit**

- a. Të përfaqësojë shoqërinë në mardhëni e saj me të tretët, në administratën publike dhe në organet gjyqësore
- b. Hap llogari bankare në emër të shoqërise pranë ç do banke të nivelit të dytë sipas legjislacionit shqiptar brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj.
- c. Të emërojë dhe shkarkoje pranë shoqërisë personelin e dobishëm që i nevoitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtarë dhe ekonomik
- d. Të paraqesë përmiratim në asamblenë e ortakëve strukturën e brendëshme orgazizative të shoqërisë me emrat përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë.

- e. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufinjëve të përcaktuar nga asambleja e Ortakëve.
- f. Të testojë aftësine e punonjësve në administratë
- g. Të thërrasë asamblene e ortakëve dhe të propozojë cështjet që duhen analizuar
- h. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrate të lëna nga Asambleja e Ortakëve;
- i. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe ti paraqesë ato për miratim nga asambleja e ortakeve.

*Të bëjë rregjistrimin filletar të shoqërisë pranë QKR Tiranë apo të japë prokurë për kryerjen e saj.*

Administratori është përgjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjëve, për shkelje të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### Neni 20

##### **Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të Administratorit**

20.1 Akti i emërimit dhe shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përcaktojë periudhën për të cilën është emëruar administratori, pagën etj.

20.2 Me emërimin e administratorit midis tij dhe ortakëve nënshkruhet një kontratë punësimi në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë

20.3 Adminsitratori mund të shkarkohet në rast se ai përmbrush detyrimet që rrjedhin për të nga ky statut, kontrata e punës si dhe #do akt tjeter ligjor dhe nënligjor që lidhet me funksionet e tij

20.4 Adminsitratori mund të shkarkohet edhe kur humbet besimin e Asamblesë së Ortakëve

20.5 Akti i shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përbajë shkaqet e shkarkimit

20.6 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit mbarojnë menjëherë me Aktin e shkarkimit

#### Neni 21

##### **Personeli i shoqërisë**

- 21.1 Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohet të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si edhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
- 21.2 Marrja në punë bëhet me rregjistrim nga punëdhënësi në Librin e Punës së shoqërisë, si edhe duke njoftuar organet e punës së juridiksonit ku ushtron veprimtarinë Shoqëria;
- 21.3 Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim nga administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesë të të interesuarit.
- 21.4 Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë vëprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojë nga një pëerfaqësues me procure. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës së rrëthit Gjyqësor.

#### KREU IV

#### MBLEDHJET DHE VENDIMARRJA NË SHOQËRI

##### Neni 22

##### Aktet e Asamblesë së Ortakëve

- 22.1 Asambleja e Ortakëve administron shoqërinë nëpërmjet akteve të ndryshme të miratuara prej tyre
- 22.2 Aktet duhet të jenë me shkrim si dhe të rregjistrohet në një rregjistër të posaçëm
- 22.3 Në rastet e shqyrimit të raporteve të Administratorit, të inventarit si dhe të miratimit të llogarive vjetore, Asambleja e Ortakëve njofton Administratorin dhe/ose likujdatorin, sipas rastit, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së shqyrimit.

#### KREU V

#### VITI FINANCIAR, RAPORTET VJETOARE, FITIMI

##### Neni 23

##### Viti finanziar

9

- 23.1 Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve e fitimit për shoqërinë bëhet ç do vit financiar  
23.2 Cdo vit financiar fillon më datën 01 janar dhe mbylljet në datë 31 dhjetor.

#### **Neni 24**

##### **Raportet vjetore**

- 24.1 Administratori ose sipas rastit eksperti kontabël parqet raportet vjetore financiare jo më vonë se dymujori i parë i viti financiar pasardhës  
24.2 Raporti përban të dhëna mbi të ardhurat, shpenzimet si dhe çdo informacion tjetër financiar mbi shoqërinë  
24.3 Asambleja e Ortakëve miraton raportet financiare dhe llogaritë vjetore të viti financiar jo më vonë se 6 mujori i parë i viti financiar pasardhës

#### **Neni 25**

##### **Eksperti Kontabël**

- 25.1 Emërimi i ekspertit kontabël bëhet nëpërmjet një akti me shkrim i cili i komunikohet personit të caktuar si ekspert kontabël i autorizuar.  
25.2 Eksperti kontabël emërohet për një periudhë prej 2 vitesh financiare duke përfshirë në këtë periudhë edhe vitin financiar në të cilin bëhet emërimi.

#### **Neni 26**

##### **Shkarkimi i Ekspertit kontabël**

- 26.1 Eksperti kontabël shkarkohet me vendim të Asamblese se Ortakëve  
26.2 Akti i shkarkimit duhet të bëhet me shkrim

#### **Neni 27**

##### **Fitimi i shoqërisë**

- 27.1 Fitimi i shoqërisë llogaritet në fund të çdo viti financiar  
27.2 Shpërndarja e fitimi bëhet me vendim të Asamblese se Ortakëve pasi është lënë më parë mënjanë rezerva e detyrueshme.

27.3 Ortakët mund të disponojnë lirisht fitimin e shoqërisë pasi të jenë lënë më parë mënjanë rezerva të detyrueshmë dhe të jenë shlyer të gjitha detyrimet që shoqëria ka kundrejt shtetit për këtë fitim

## KREU VI

### PRISHJA, SHPËRNADARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

#### Neni 28

##### Prishja e shoqërisë

28.1 Shoqëria mund të prishet me vendim të Asamblesë së ortakëve.

28.2 Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet të jetë me shkrim dhe duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit

#### Neni 29

##### Shndërrimi i shoqërisë

29.1 Një shoqëri tregëtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit si më poshtë:

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas

29.1 Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve

#### Neni 30

##### Likujdimi i shoqërisë

30.1 Në rast falimentimi të shoqërisë, ajo kalon në proces likujdimi;

30.2 Shoqëria është në process falimentimi kur ajo është në pamundësi të pagesave ndaj të tretëve;

30.3 Në procesin e likujdimit, Asambleja e Ortakeve ose gjykata cakton një likujdator, ekspert kontabël për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërisë;

30.4 Procesi i likujdimit i paraqitur nga eksperti kontabël miratohet nga Asambleja e Ortakeve ose nga Gjykata;



- 30.5 Në procesin e likujdimit shoqëria përfaqësohet nga likujdatori i cili është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët në përputhje me rradhën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar;
- 30.6 Pas përfundimit të procesit të pagimit të kreditorëve, vlera financiare dhe kapitalet e tjera të shoqërisë, nëse ka, i dorëzohen Asamblesë së Ortakëve;
- 30.7 Aktet e likujdimit në përfundim të tij së bashku me llogaritë përkatëse depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Pas kësaj shoqëria çrrregjistrohet nga ky rregjistër;

## KREU VII

### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 31

##### Ndryshimet në statut

- 31.1 Ky statut përbën dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelin dhe organizimin e veprimtarisë së saj. Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 31.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do ti referohen legjislacionit tregëtar shqiptarë në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

#### Neni 32

##### Hyrja në fuqi

Ky statut është i hartuar në katër kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

## ORTAKET

Znj. Fabjola Belegu



Z. Orges Poda



12

